

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8952, DATË 10.10.2002, “PËR LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE SHQIPTARË”, I NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj synon krijimin e mundësisë për pajisjen me letërnjoftim digjital (e-letërnjoftim) për të gjithë shtetasit e pajisur me letërnjoftim elektronik, në zbatim të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar”, me qëllim përmbushjen e agjendës politike të qeverisë shqiptare, në kuadër të digjitalizimit, modernizimit të sistemeve elektronike, si dhe zbatimin e skemave të sigurta të shërbimeve e-ID. Pajisja me letërnjoftim digjital (e-letërnjoftim) ka për qëllim përmirësimin dhe standardizimin e mënyrave të identifikimit të qytetarëve në ambientin digjital.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKË

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, që paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave, për Ministrinë e Brendshme.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Nevoja për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar”, është në

përputhje me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian, përkatësisht Rregulloren e Be nr. 910/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 23 korrik 2014, “*Mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm*”. Në vitin 2024, Bashkimi Evropian (BE) zbatoi një rregullore të re për identitetin digjital, e cila ka synuar të përmirësojë dhe standardizojë mënyrat e identifikimit të qytetarëve në ambientin digjital. Identiteti digjital, si një mjet që mundëson njohjen e një personi në ambientin digjital, përfshin informacione personale, si emrin, datën e lindjes, adresën, dhe të tjera të dhëna të rëndësishme, duke krijuar mundësinë e sigurimit të një përputhje të lartë të standardeve dhe sigurisë në të gjithë vendet anëtare, për të lehtësuar lëvizjen dhe komunikimin nëpërmjet platformave dixhitale brenda BE-së dhe për të forcuar sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Për këtë arsye, miratimi i këtij projektligji, do të përmbushë objektivat e qeverisë në drejtim të identitetit digjital, duke standardizuar identifikimin e qytetarëve në nivel evropian dhe implementuar një identitet digjital të përbashkët, i cili mund të lehtësojë komunikimin dhe bashkëpunimin me institucionet dhe bizneset evropiane. Gjithashtu, një identitet digjital i përbashkët gjithashtu mund të ndihmojë në luftën kundër krimit të organizuar dhe mashtrimeve në internet, duke rritur sigurinë dhe besueshmërinë e transaksioneve online. Ministria e Brendshme, e në veçanti shoqëria aksionare IdentiTek, si shoqëria e cila prodhon dhe shpërndan dokumente biometrike për shtetasit shqiptarë dhe/ose shtetasve të huaj me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, sjellin këtë propozim në përputhje me kuadrin rregullator në Republikën e Shqipërisë, në tërësi, si dhe në përmbushje të kompetencave sipas vendimit nr. 80, datë 14.02.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike”.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të nenit 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj përbëhet nga 10 nene, si më poshtë vijon:

Në nenin 1, të projektligjit, parashikohet shtimi i togfjalëshit “dhe digjital” në titullin e ligjit.

Në nenin 2, të projektligjit, parashikohet shtimi i togfjalëshit “elektronik ose digjital” në nenin 1.

Në nenin 3, të projektligjit, parashikohet shtimi i mundësisë për pajisjen me letërnjoftim digjital, si një nga dy format e letërnjoftimit. Gjithashtu, parashikohet se rregullat dhe procedurat për paraqitjen e kërkesës për pajisjen me letërnjoftimin elektronik dhe digjital, si dhe dokumentet e nevojshme që shoqërojnë kërkesën, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.

Në nenin 4 të projektligjit parashikohet se shtetasit që nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç, kanë të drejtë të pajisen me letërnjoftim me kërkesë të prindërve ose kujdestarit të tyre.

Në nenin 5 të projektligjit parashikohet shfuqizimi i fjalës “elektronik”.

Në nenin 6 të projektligjit parashikohen kushtet e pajisjes me letërnjoftim të ri.

Në nenin 7 të projektligjit parashikohet ndryshimi i shkronjës “b” të nenit 5/1, në përputhje dhe me ndryshimin e nenit 5 të ligjit.

Në nenin 8 të projektligjit përcaktohet përkufizimi i letërnjoftimit digjital, si dhe elementët që përfshihen në të. Gjithashtu, parashikohet se të dhënat e tjera digjitale që përfshihen në letërnjoftimin digjital, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.

Në nenin 9 të projektligjit parashikohen shtimi i nenit 6/1, i cili përcakton të drjetën për prodhimin e letërnjoftimit digjital, nga shoqëria aksionare përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike, vetë ose në bashkëpunim me shoqëri të tjera, që përmbushin kushtet. Gjithashtu parashikohet se rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e shoqërive që mund të bashkëpunojnë me shoqërinë aksionare përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrik për prodhimin e letërnjoftimeve digjitale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 10 të projektligjit parashikohen institucionet e ngarkuara me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Në nenin 11 të projektligjit parashikohet hyrja në fuqi e këtij projektligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTLIGJIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Brendshme dhe shoqëria aksionare IdentiTek sh.a.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj është hartuar nga Drejtoria e Programimit, Standardizimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore për Çështjet e Brendshme, në Ministrinë e Brendshme dhe Departamenti ligjor në IdentiTek sh.a.. Projektligji dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk sjell efekte në buxhetin e shtetit. Efektet financiare do të parashikohen në vendimin e Këshillit të Ministrave, në zbatim të këtij ligji.

PROPOZUESI

MINISTRI

TAULANT BALLA